



**REPUBLIKA E SHQIPERISË**  
**MINISTRIA E TURIZMIT DHE MJEDISIT**  
**AGJENCIA KOMBËTARE E MJEDISIT**  
**DREJTORIA E LEJEVE MJEDISORE DHE VNM**

AN030320230017

Tiranë, më: 18.09.2023

**Komisioni 97**

**DEKLARATE MJEDISORE**

Në mbështetje të Ligjit Nr. 12/2015 “Për disa ndryshime në ligjin nr. 10440, datë: 07.07.2011, “Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis”, VKM 714, datë: 06.11.2019, për disa ndryshime dhe shtesa në VKM 686, datë: 29.07.2015, “Për miratimin e rregullave, përgjegjesive e afateve, për zhvillimin e procedurës së transferimit të Vendimit e Deklaratës Mjedisore”, të ndryshuar, dhe me propozim të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, Ministri

**VENDOSI:**

**Lëshimin e Deklaratës Mjedisore negative, për Zhvilluesin me të dhënat si më poshtë:**

**Personi Juridik:** “EDG NATURAL GAS” sh.p.k

**Nr. NIPT-i:** M11707029T

**Adresa e selisë:** Rruga e Elbasanit, Vila Nr.71, Njësia Administrative Nr.2, Tiranë

**Personi përgjegjës:** Erald Bakiu

Për të zhvilluar projektin “**Zhvillimi dhe prodhimi i hidrokarbureve në vendburimin Povelçë, ( 3 puse ekzistues, Povelçë 1/b, Povelçë 9 dhe Povelçë 13 dhe shpimi i një pusi të ri të emërtuar Povelçë -32b) ”**

Aplikimi është bërë referuar ligjit Nr. 10 440, date: 7.7.2011 “Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis”, Shtojca I, “Projektet që i nënshtrohen Proçedurës së Thelluar të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis”, pika 14 "Nxjerrja e naftës dhe gazit natyror për qëllime tregtare, ku masa e nxjerrje e tejkalon nivelin prej 50 tonë/ditë në rastin e naftës dhe 10 000 m<sup>3</sup> /ditë në rastin e gazit").

**Vendndodhja:** Vendburimi Povelçë ndodhet në Njësia Administrative Levan dhe Dermenas, Bashkia Fier.

Rehabilitim i puseve ekzistuese: Povelçë 1/b

Povelçë 9

Povelçë 13

Hapje pus i ri: Povelçë -32b

*(Bashkangjitur Anex 1 Harta dhe koordinatat ku tregohet vendodhja e objektit )*

Bazuar në nenin 12, të ligjit nr.10440, date 7.7.2011, "Për vlerësimin e ndikimit në mjedis", i ndryshuar, i sugjerohet autoritetit planifikues:

*Refuzimi i kërkesës për leje/licencë zhvillimi për atë projekt, për shkak të ndikimeve të rëndësishme negative në mjedis me pasoja afatgjata, që dëmtojnë cilësinë e mjedisit dhe nuk mundësojnë përmbushjen e standardeve mjedisore përkatëse*

Bazuar në pikën 2, të nenit 12, të ligjit nr.10440, datë: 7.7.2011, "Për Vlerësimin e Ndikimit Në Mjedis", të ndryshuar, më poshte po listojmë:

### **1. Qëndrimin e Drejtorive Teknike:**

*Drejtoritë Teknike të Ministrisë shprehen:* Me qëllim mbrojtjen e cilësisë së ajrit në mjedis dhe në zbatim të legjislacionit përkatës për këtë fushë, sugjerohet që gjatë fazës së ushtrimit të aktivitetit, duhet të mbahen në konsideratë rekomandimet e mëposhtme:

- Të respektohen normat e lejuara të shkarkimeve në ajër të ndotësve të gaztë dhe lëndës së ngurtë pezull, në zbatim të VKM-së nr. 435, datë 12.9.2002 "Për miratimin e normave të shkarkimeve në ajër në Republikën e Shqipërisë";

- Të spërkatet rregullisht me ujë sheshi i ndërtimit dhe rrugët e transportit, për mbajtjen nën kontroll të pluhurformimit, si dhe forcimin e zbatimit të këtyre masave edhe më shumë në kohën e thatë dhe me erë, në zbatim të VKM-së nr. 412, datë 19.6.2019 "Për miratimin e planit kombëtar për menaxhimin e cilësisë së ajrit";

- Të sigurohen struktura brenda sheshit të ndërtimit për larjen dhe pastrimin e automjeteve/rrotave të automjeteve, para daljes nga sheshi i ndërtimit, në zbatim të VKM-së nr. 412, datë 19.6.2019 "Për miratimin e planit kombëtar për menaxhimin e cilësisë së ajrit".

Gjithashtu gjatë fazës së funksionimit, impianti të jetë i pajisur me filtra për kapjen e gazeve në mënyrë që të reduktohen shkarkimet e tyre në ajër.

Në zbatim të legjislacionit përkatës për fushën e menaxhimit të kimikateve, sugjerohet që si gjatë fazës së punimeve ashtu edhe gjatë fazës së funksionimit, të mbahen në konsideratë rekomandimet e mëposhtme:

- Subjekti dhe punonjësit duhet të jenë të familjarizuar dhe të respektojnë në mënyrë rigorozë masat dhe rekomandimet për mbrojtjen, sigurinë e njeriut dhe mjedisit, nga kimikatet që do të përdoren për qëllime të këtij aktiviteti, në zbatim të ligjit nr. 27/2016 "Menaxhimi i kimikateve";

- Kimikatet ose produktet/artikujt që i përmbajnë ato, që do të përdoren, duhet të jenë të klasifikuara, etiketuara, paketuara dhe të shoqërohen me dokumentacionin me të dhënat e sigurisë kimike (MSDS), sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi (VKM-së nr. 488, datë 29.6.2016 "Për klasifikimin, etiketimin dhe ambalazhimin e kimikateve", si dhe VKM-së nr. 9, datë 9.1.2019 "Për rregullat e detajuara dhe metodat për kryerjen e vlerësimit të sigurisë së kimikatit, si edhe kërkesat specifike, përmbajtja dhe formati i dokumentit me të dhënat e sigurisë");

- Kimikatet ose produktet/artikujt që i përmbajnë ato, që do të përdoren, duhet të ruhen dhe menaxhohen në mënyrë të sigurt, në zbatim të ligjit nr. 27/2016 "Menaxhimi i kimikateve". Në zbatim të legjislacionit përkatës për fushën e ndryshimeve klimatike, rekomandohet të kryhen punime miqësore me mjedisin dhe të krijohen hapësira të gjelbra përreth;

• Sugjerojmë që mbetjet e gjeneruara gjatë zhvillimit të aktivitetit të menaxhohen sipas kuadrit ligjor në fuqi në fushën e mbetjeve.

Sugjerojmë të merret mendimi i Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura.

• Sa i takon sektorit të pyjeve, shprehet se: Vleresojmë se në çdo rast duhet të kihet parasysh zbatimi me rigorizitet i ligjit 57/2020, datë 30.4.2020 "Për Pyjet" veçanërisht neni 12 i tij.

• Sa i takon sektorit të cilësisë dhe pastërtisë së mjedisit shprehet që subjekti gjatë zhvillimit të aktivitetit duhet ti përmbahet legjislacionit në fuqi në lidhje me zhurmat.

Bazuar në nenin 12, pika 1 e ligjit nr. 10440 / 2011 "Për vlerësimin e ndikimit në mjedis" të ndryshuar, në rast se zgjidhni pikën "a" apo "b" të referencës ligjore së sipërcituar, në Deklaratën Mjedisore të vendosen kushte të detajuara përsa i përket mbrojtjes së biodiversitetit, menaxhimit të pyjeve,

emetimeve në ajër, shkarkimeve të ujrave të ndotura, menaxhimit të mbetjeve, etj. Të cilat duhet të përmbushen nga zhvilluesi, për të parandaluar, minimizuar dhe menaxhuar ndikimet negative në mjedis.

*Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura shprehet:*

Bazuar në planvendosjen dhe koordinatat e aplikimit, sipërfaqja e objektit: “Zhvillimi dhe prodhimi i hidrokarbureve në vendburimin Povelçë” (3 puse ekzistues, Povelçë 1/b, Povelçë 9 dhe Povelçë 13 dhe shpimi i një pusi të ri të emërtuar Povelçë -32b), Levan dhe Dërmenas, Bashkia Fier, me zhvillues “EDG NATURAL GAS” dhe aplikues “Environmental Management Consultants” sh.p.k, me nr. Aplikimi AN030320230017, rezulton se sipërfaqja (zona) ku kërkon të bëhet shpimi i një pusi të ri të emërtuar Povelçë -32b, nuk ndodhet brenda rrjetit të zonave të mbrojtura, ndërsa sipërfaqja (zona) ku ndodhen pusët ekzistues Povelçë 1/b, Povelçë 9 dhe Povelçë 13, ndodhen në zonën e mbrojtur PM “Pishë Poro Nartë”, shpallur me VKM-në nr. 694, datë 26.10.2022 “Për ndryshimin e statusit dhe të sipërfaqes së ekosistemit natyror/ligatinor “Pishë Poro – Nartë” nga “Rezervat natyror i menaxhuar” në “Peizazh i mbrojtur” dhe heqjen e statusit “Zonë e mbrojtur” të sipërfaqes së pakësuar”. Konkretisht pusi Povelçë 1/b, ndodhet në nënzonën qendrore (ZQ) dhe pusët Povelçë 9 dhe Povelçë 13, në nënzonën e përdorimit tradicional dhe të qëndrueshëm (ZPT/Q).

Referuar ligjit nr. 81/2017 “Për zonat e mbrojtura”, neni 20, pika 1, citon se: “Peizazh i mbrojtur” shpallen territore të mëdha, me peizazh harmonik e të formuar mirë, me relief të zhvilluar karakteristik, me larmi ekosistemesh, detare ose tokësore, sipërfaqet brenda të cilave mund të ketë edhe qendra banimi që zhvillojnë aktivitete, si bujqësia, pemëtaria, pylltaria e peshkimi”.

Neni 13 “Ndarja në nënzona i territorit të zonës së mbrojtur kombëtare “, Pika 3, shkronja a, citon se: *Zonimi përputh shkallën e mbrojtjes me veçoritë e nënzonës, duke mbajtur parasysh natyrën e zonës, llojet e veprimtarive njerëzore që zhvillohen në të dhe ndikimin e tyre në mjedis.* a) **Në nënzonën qendrore (që ka si funksion ruajtjen tërësore të biodiversitetit dhe siguron një zonë natyrore të pashqetësuar) përdoret shkalla e parë e mbrojtjes (strikte).**

Sipas VKM-së nr. 694, datë 26.10.2022, nënzona qendrore, e shënuar në hartë me (ZQ), përfshin habitatet kryesore pyjore e shkurre dhe **përcaktohet si zonë me vlera të larta e t rralla për trashëgiminë natyrore e biodiversitetin dhe në të zbatohet shkalla më e lartë e mbrojtjes, që siguron një territor të pashqetësuar. Në këtë nënzona lejohen kërkimi shkencor dhe zhvillimi i veprimtarive ekoturistike të lira në natyrë.**

Nënzona e përdorimit tradicional dhe zhvillimit të qëndrueshëm, e shënuar në hartë me (ZPT/Q), përfshin tokat pyjore e bujqësore, kullotat dhe territore ujore ku mundësohet vazhdimi i veprimtarive tradicionale, si punime për shëndetësimin e pyjeve, aktivitete bujqësore, kullotja, grumbullimi dhe kultivimi i bimëve mjekësore e aromatike, me përdorim të balancuar të tyre dhe nuk lejohen ndërtimet e veprimtaritë ekonomike që shkaktojnë ndryshimin e gjendjes natyrore të ekosistemit natyror. Në nënzonën e përdorimit tradicional dhe zhvillimit të qëndrueshëm zbatohet shkalla e dytë e mbrojtjes, që siguron një territor me ndikim të ulët dhe kontroll të veprimtarive ekonomike, sociale, agrobiznesit, argëtuese, sportive e ekoturistike, ndërtimi i infrastrukturës sipas planeve të zhvillimit urban e turistik, të miratuar nga Këshilli Kombëtar i Territorit (KKT), **të cilat nuk çenojnë integritetin ekologjik të ekosistemit natyror dhe respektojnë funksionet e zonës së mbrojtur, vlerat ekologjike dhe ato të peizazhit natyror e kulturor.**

**Referuar akteve ligjore të mësipërme, në kushtet ku pusi Povelçë 1/b, ndodhet në zonën qendrore të peizazhit, e cila është zonë strikte, rehabilitimi dhe ndërhyrjet në këtë pus nuk mund të zhvillohen.**

Për dy pusët Povelçë 9 dhe Povelçë 13, kërkojmë nga subjekti zhvillues që gjatë kryerjes së punimeve për përmirësimin e rrugëve ekzistuese, mbetjet urbane dhe ato të ngurta që gjenerohen duhet të largohen nga territori i peizazhit dhe të sistemohen në venddepozitimin e miratuar nga bashkia.

Rrethimi i puseve që do të prodhohet gaz të realizohet me materiale në harmoni me mjedisin. E gjithë sipërfaqja që aksidentohet, të rehabilitohet me punime të tilla si, mbjellje pemësh, shtresa bari, etj.

Agjencia Rajonale e Mjedisit Fier/Vlorë/Gjirokastrë ngriti grupin e punës më datë 13.03.2023 për Subjektin: “EDG Natyral Gas” sh.p.k me Aktivitet: “Zhvillimi dhe Prodhimi i Hidrokarbureve në vendburimin Povelça”, me vendodhje: Njësia administrative Dermenas, Levan, Fshati Darzezë e Re, Povelçë, Bashkia Fier, Qarku Fier. Ndikimet më të mëdha negative të këtij aktiviteti janë ndryshimi i peisazhit në një sipërfaqe të caktuar që presupozon sheshet dhe territoret e puseve të gazit. Sugjerime:

- Të bëhet menaxhimi i mirë i mbetjeve sterile dhe dherave që do të prodhohen gjatë fazës së studimit për zbulimin e Gazit Natyror në zonë.
- Të evitohet efekti i mundshëm i erozionit në zone
- Mbetjet inerte që do të gjenerohen nga procesi i punës të trajtohen sipas kërkesave të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 575, datë 24.06.2015 "Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e mbetjeve inerte"
- Të bëhet sistemimimi i dherave në sheshet e puseve për të gjithë sipërfaqen që do të shfrytëzohet për të krijuar sipërfaqet për mbjellje pemësh të zonës duke përmirësuar dhe peisazhin natyror dhe rritur cilësinë e ajrit në zonë.
- Mbetjet sterile dhe inerte të ripërdoren për rehabilitimin e zonës së shfrytëzimit dhe për ndërtimin e një sërë rrugësh të brendshme në zonën e puseve.
- Të përdoret ujë për lagjen e territorit në formë spërkatje për shmangien e pluhurave.
- Të monitorohet niveli i zhurmave sipas Udhëzimit Nr.8, datë 27.11.2007 “Për nivelet kufi të zhurmave në mjedise të caktuara.
- Të zbatohet legjislacioni mjedisor në fuqi gjatë fazës së studimit dhe shfrytëzimit.
- Territori ku kryhet aktiviteti duhet të rrethohet me tabela paralajmëruese ku të tregohet për punimet që kryhen, radhën e kryerjes së tyre dhe rrezikshmërinë.
- Të kryhet rehabilitimi përfundimtar i shesheve të puseve, rrugëve lidhëse të puseve, shesheve të depozitimit të sterileve etj.
- Të llogariten distancat e rrezikshme nga përdorimi i lëndëve plasëse, nëse do të duhet të përdoren, për efekt të kërkimeve të gazit natyror .
- Lidhur me sigurinë e jetës së punonjësve në territor të përdoren pajisje sinjalizuese të cilat evidentojnë rrjedhje e mundshme të gazit natyror dhe shpëtojnë jetë.
- Shpërthimet dhe plasjet me eksploziv të kryhen në orare të tilla që zhurmat të kenë ndikim minimal në zonën përreth dhe të mos kenë efekte në banesat e komuniteteve lokale. Në rast se do të ketë dëme materiale për efekt të kryerjes së operacioneve hidrokarbure nga kompania EDG Natyral Gaz të realizohet dëmshpërblimi sipas legjislacionit vendas në fuqi.
- Përgjatë gjithë rrugës së brendshme të puseve të vendosen sinjalistikat përkatëse duke ju krijuar mundësinë punonjësve dhe banorëve të komuniteteve zonal të orientohen sipas rregullave në zonat industriale.
- Nëse do të kemi ndërhyrje në rrugët e aksesit në zonat e puseve këto do të nevojitet të realizohen me projekte të studiuara mirë duke u marrë në konsideratë dhe rehabilitimi i plotë i mjediseve të dëmtuara nga ndërhyrjet siç parashikohet në legjislacionin mjedisor.
- Të respektohet ligji 57/2020, datë 30.04.2020 “Për pyjet”

**2. Ministria ka marrë në shqyrtim mendimet e shprehura nga publiku dhe institucionet përkatëse, si dhe shkallën e reflektimit të tyre;**

**3. Informacion për procesin e realizuar të konsultimit me publikun:**

Morën pjesë përfaqësues nga komuniteti i zonës, banorë, kryetar i fshatit Darëzësë e re, drejtues teknik i subjektit, specialist nga Ministria e Energjisë, përgjegjës i "Alpetrol" Sha, ekspert i mjedisit dhe nga Agjencia Rajonale e Mjedisit . Në takim është prezantuar projekti, janë dëgjuar sugjerimet e pjesëmarrësve, të cilat do të merren parasysh nga ana e investitorëve, gjatë kohës së shfrytëzimit. Nga ana e investitoreve sigurova të pranishmeve që do të merren të gjitha masat për eliminimin e ndikimeve negative në mjedis, duke mos cënuar jetën e banorëve.

#### **4. Arsyet dhe konsideratat kryesore, ku është mbështetur mendimi:**

1. Bazuar në mendimin e AKZM-së, pushtet ndodhen pranë zonave me status të veçantë, zbatimi i këtij projekti bie në kundërshtim me veprimtaritë e lejuara në zonat e mbrojtura mjedisore dhe cënon integritetin ekologjik të ekosistemit natyror.
2. Bazuar në VKM Nr 699, datë 16.08.2013, Shoqëria "Alpetrol" sha ka lidh Marrëveshje Hidrokarbure "Për zhvillimi dhe prodhimin e hidrokarbureve në Vendburimin e Gazit Natyror Povelcë, në Shqipëri" midis shoqërisë "Alpetrol" Sh.a, dhe shoqërisë "Phoenix Petroleum" Sh.a. Kjo marrëveshje është mbyll dhe shoqëria "Alpetrol" sha ka marrë në dorëzim nga grupi i punës datë 27.02.2018 vendburimin e gazit natyror Povelcë, Vendburimi Povelcë.
  - Referuar procesverbalit të dorëzimit të puseve nga shoqëria "Alpetrol"sha tek Kopania kontraktore "EDG Natural Gas" shpk (Povelçe 1/b, 9, 13 dhe 23) dhe Leja e Mjedisit (Nr 10138 prot, datë 20.10.2014) që posedon shoqëria "Alpetrol" Sh.a, lidhur me aktivitetin hidrokarbure që kryen në vendburimin Povelcë, rezulton ekzistues.
  - Në zbatim të Ligjit nr. 10 440, datë 07.07.2011 "Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis", të ndryshuar, KREU I, Neni 1, Pika a) qëllimi i tij është të sigurojë një nivel të lartë të mbrojtjes së mjedisit, përmes parandalimit, minimizimit dhe kompensimit të dëmeve në mjedis, nga projekte të propozuara që përpara miratimit të tyre për zhvillim. KREU II, Neni 1. Projektet private apo publike, të listuara në shtojcat I dhe II, bashkëlidhur këtij ligji, i nënshtrohen vlerësimit të ndikimit në mjedis, në përputhje me kërkesat e kreut II të këtij ligji, përpara dhënies së lejes përkatëse nga autoriteti përgjegjës për zhvillimin ose jo të projektit, AKM nuk mund të propozojë lëshimin e Deklaratës Mjedisore në të tilla rrethana.

**DREJTORI I PËRGJITHSHËM**

**ARTA DOLLANI**

**MINISTRI**

**MIRELA KUMBARO FURXHI**

*Konceptoi:*

*Pranoi:*

**Aneksi 1. Harta me koordinatat (sipas AKZM-së)**

